



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail.. contact@pallatirinise.com

www.pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të miratuar me datën **27.09.2021** nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë **06.10.2021, SHPALLË:**

KONKURSIN PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Sigurim/Zjarrfikës në Departamentin e Sigurimit - dy (2) vende pune;

II. Numri i referencës: NPL -D.M. 06/10/2021;

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:

- I kryen të gjitha urdhëresat e Përgjegjësit të ndërrimit, përgjegjësi i njësisë së sigurimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit dhe Drejtorit të Departamentit të sigurimit.

-kontrollon hyrjen e personave – njerëzve, veturave dhe automjeteve tjera për çka mbanë evidencën,

-siguron objektin e NPL “PALLATI I RINISË” SH.A. NË PRISHTINË dhe pasurinë e saj nga zjarri dhe dëmtimet tjera e ndërmerr masa për mbrojtjen e pasurisë dhe njerëzve,

-ne mënyrë të rregullt e kontrollon objektin, kohë pas kohe dhe bënë evidentimin e patrullimit.

-kontrollon hyrje – daljet në objekt nga persona te panjohur dhe i vëzhgon me kujdes të shtuar ata.

-kontrollon rregullsinë teknike të mjeteve për shuarjen e zjarrit dhe merr masa që ato të jenë në gjendje të rregullt teknike,

-raporton përgjegjësin e ndërrimit për të gjitha dukuritë në interes të sigurimit dhe mbrojtje nga zjarri .

-merr pjesë në shuarjen e zjarrit dhe organizon shuarjen e tij,

-kryen edhe punë tjera me urdhëresën e personave përgjegjës në Departament.

- Sipas orarit i caktohet pikë qëndrimi sipas orarit mujor.

- Nuk lejon të kryhen punët nga palët e treta, pa lejen me shkrim nga organet kompetente. (vlen për renovime ne qendrën tregtare).

- Nuk lejon të kryhen punët dhe aktivitet nga palët e treta, pa lejen nga zyrtaret kompetente. (vlen për aktivitetet kulturore dhe sportive).

- Kryen edhe detyrat tjera, jashtë orarit të punës, sipas rregullores së Departamentit të sigurimit.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);

Dëshmi për shkollimin e noterizuar;

Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera;

Kopja e letërnjoftimit;

Certifikata e lindjes;

Adresa e vendbanimit;

Nr. i telefonit kontaktues si dhe

E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Të ketë përgatitje të mesme shkollore e noterizuar,

- Kursi i zjarrfikësve,

- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

- Një vjet përvojë pune,

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data **06.10.2021**.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim;

- Aplikacionet për punësim mund të merren në ueb-faqën zyrtare dhe fizikisht në zyrën e Departamentit të Administratës dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim;

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.